

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 6.03.2024*

6.03.2024  
Ora 12:12

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim: “Për miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.*

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. M. Koja.**

**Parti Politike: S’ka prezent!**

**Të tjerë: KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita! Në seancën e sotme publike, kemi dy çështje në rend dite:

- Shqyrtimin e kërkesës “Për miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008

“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Kemi dhe çështjen e mbartur,

- shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të thelluar të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues, zotin Kristian Shkreli, kryetar bashkie në Bashkinë Vau-Dejës, Qarku Shkodër, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës!


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 6.03.2024*

**Z. Y. Merkaj:** Organizata “Shqipëria Bëhet”, me komitet përfaqësues të përbërë nga: Adratik Lapaj, Edlira Çepani, Florian Binaj, Renaldo Salianji dhe Ergys Llanaj kanë paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën për pajisje me fletë tip për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Bashkëlidhur kërkesës, komiteti përfaqësues ka depozituar: Projektligjin si relacionin shpjegues të projektligjit. Projektligji që do t’i propozohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ka për qëllim të bëjë shtesat dhe ndryshimet e nevojshme për të mundësuar votimin e të gjithë shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nga vendi ku ata banojnë dhe të rregullojë instrumentet se si do të realizohet procesi i regjistrimit dhe votimit të tyre. Gjithashtu, ky projektligj adreson mënyrën e hapjes së listave dhe votës së parapëlqyer për secilin kandidat të subjekteve zgjedhore, përcaktimin e formulës së llogaritjes së mandateve dhe pragut elektoral për subjektet zgjedhore. Në zbatim të nenit 10, të ligjit nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të miratojë me vendim brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës, modelin e fletës tip të mbledhjes së nënshkrimeve dhe ta publikojë atë në faqen zyrtare të KQZ-së, në një format të shkarkueshëm. Referuar nenit 13, pika 1, të ligjit “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës me shkrim të komitetit përfaqësues, duhet të përcaktojë me vendim, sipas propozimit të komitetit përfaqësues, periudhën kohore gjatë të cilës zhvillohet procesi i mbledhjes së nënshkrimeve, në vendet publike dhe private, si dhe nënshkrimeve elektronike. Periudha kohore gjatë të cilës do të zhvillohet procesi i mbledhjes së nënshkrimeve, sipas kërkesës së plotësuar nga komiteti përfaqësues në datën 29 shkurt 2024 është

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 6.03.2024*

nëntëdhjetë ditë nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, dy kërkesat e komitetit përfaqësues, projektligjin si dhe relacionin shpjegues të projektligjit, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Mirë faleminderit! Atëherë, meqenëse kërkesa e komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse përbërë nga: Adratik Lapaj, Edlira Çepani, Florian Binaj, Renaldo Salianji dhe Ergys Llanaj është në parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe ligjit “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”, e miratojmë duke miratuar dhe formularin tip për mbledhjen e nënshkrimeve. Për realizimin e procedurës për mbledhjen e nënshkrimeve, caktojmë një afat nëntëdhjetë ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Mirë atëherë, çështjen tjetër përsëri do ta shtyjmë, sepse ende nuk kemi marrë një përgjigje nga SPAK, në lidhje me statusin e subjektit vetëdeklarues, në kuadër të ndonjë hetimi penal të mundshëm ndaj tij, nga ky organ.

Mirë, çështje të tjera nuk kemi?! Në rregull, seanca mbyllet, ditë të mbarë!

**Vendimi nr. 28**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

